

VENDIM
Nr. 440, datë 18.7.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE MARQINET DHE AMBIENTEVE SPORTIVE
NË FUNKSION TË SAJ”,
NË BASHKINË VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Marqinet dhe ambienteve sportive në funksion të saj”, në Bashkinë Vorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 4 273 749 (katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 273 749 (katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vorë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vorë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE PRIVATE
ZËRI KADASTRAL: AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ.,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE MARQINET DHE
AMBIENTEVE SPORTIVE NË FUNKSION TË SAJ”, NË BASHKINË VORË

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adr.	Pronari	Sipërf. truall	Sipërf. ndërt.	Çmimi i truall lekë/m²	Çmimi i ndërt. lekë/m²	Vlera e truall. lekë	Vlera e ndërtimit, lekë	Vlera e truallit dhe e ndërtesës	Shënime
1	2605	Vërtetim hipotekor nr. 206 , datë 6.11.2003		Bashkëpronarët: Besnik Jonuz Beu, Dallandyshe Qemal Beu	175	78	2,560	--	448,000	1,585,262	2,033,262	Vlera e objektit është përlogaritur me preventiv punimesh
2	2605	Vërtetim hipotekor nr. 253 , datë 5.11.2002		Bashkëpronarët: Pelivan Çjapi, Kozeta Çjapi (Kokaj)	139	102	2,560	--	355,840	1,884,647	2,240,487	Vlera e objektit është përlogaritur me preventiv punimesh